



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2018**

**Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në shërbim të:**

- Sigurimit të gatishmërisë operacionale dhe vigjilencës ndaj çdo situate që mund të ketë ndikim në stabilitetin financier në vend;
- Ruajtjes së stabilitetit financier dhe shmangies së krizave të mundshme financiare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit përfundimtar të shërbimeve bankare, nëpërmjet ndërtimit të urave të komunikimit ndërmjet autoriteteve rregulatorë dhe mbikëqyrëse të sistemit bankar shqiptar;
- Rolit të ri që iu caktua me ligjin nr. 133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" si administratore e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

**Konstaton se gjatë vitit 2018 Agjencia:**

- Ka vijuar të mbetet e angazhuar në drejtim të përbushjes me eficencë të mandatit të saj ligjor, e udhëhequr edhe nga rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për këtë vit.
- Ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional, si anëtar i Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, dhe ka qenë në kontakt dhe konsultim të vazhdueshëm me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, si partnerët strategjikë parësorë të Agjencisë në drejtim të objektivit të përbashkët të stabilitetit financier.
- Ka konsideruar dhe ka marrë masa për respektimin dhe vënien në zbatim për vitin 2018 edhe të rekomandimeve të Kuvendit.

## **Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Agjencisë së Sigurimit të Depozitave që gjatë vitit 2019:**

- Në zbatim të përcaktiveve ligjore dhe duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë, si dhe përputhshmérinë me standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave, të shqyrtojë dhe të vlerësojë përshtatshmérinë e treguesve të skemës së sigurimit të depozitave, duke përfshirë, ndër të tjera, normën e primit të sigurimit, nivelin e mbulimit për depozitat e siguruara, kategoritë e depozitave të sigurueshme dhe atyre të përjashtuara nga sigurimi, si dhe raportin e synuar të mjaftueshmérisë së fondeve që Agjencia administron.

- Të vijojë testimin e sistemit, për sa i takon gatishmérisë në rast ngjarjeje sigurimi, infrastrukturën IT, komunikimin me depozitivesit, ashtu si dhe bankën në likuidim dhe bankën agente të përzgjedhur nga Agjencia për kryerjen e një procesi kompensimi, duke kryer simulime teknike dhe tematike, si dhe duke u angazhuar në simulimet ndërinstitucionale apo simulime për raste të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim testimin e procedurave operacionale të hartuara në letër.

- Të thellojë më tej bashkëpunimin me Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar dhe në veçanti me Bankën e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë rolin kyç të këtij institucioni, si autoriteti përgjegjës rregulator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar dhe financiar, si dhe misionin e përbashkët të dy institacioneve në drejtim të zhvillimit të një sistemi financiar të shëndetshëm në shërbim të publikut dhe ruajtjen e qëndrueshmérisë.

Miratuar në datën 8.5.2019